


Autoriteti i likuidimit për NSH "Tregu" publikon këtë:

**NJOFTIM PËR ZGJATJEN E AFATIT**

Njoftim për zgjatjen e afatit për aplikim në shpalljen publike të datës 22.01.2024 për 7 pozita për vendin e punës Ofrues i Shërbimeve – Inkasantë të NSH "Tregu" me Nr. të referencës 22012024. Afati për aplikim zgjatet për shkak se numri i aplikacioneve të pranuar nuk ka qenë i mjaftueshëm. Afati zgjatet edhe për 15 ditë përkatësisht shpallja mbetet e hapur deri me datë 20.02.2024 në ora 16:00.

Nënshkrimi



Autoriteti i Likuidimit për NSH "Tregu"

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Në bazë të nenit 3, paragrafi 2 të Rregullores nr. 06/2020 angazhimin e Ofruesve të Shërbimeve (OSH) në procesin e likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH), Autoriteti i Likuidimit shpallë këtë:

## Konkurs per Ofrues të Shërbimeve në procesin e likuidimit

<b>Titulli i pozitës së punës</b>	Ofrues i Shërbimeve – Inkasantë
<b>Kohëzgjatja e emërimit</b>	6 mujor
<b>Paga (bruto) përfshirë kontributet e punëdhënësit</b>	330.00 Euro
<b>Nr. i kërkuar</b>	7
<b>Data e njoftimit</b>	22.01.2024
<b>Afati për aplikim</b>	26.01.2024
<b>Institucioni</b>	Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)
<b>Departamenti</b>	Departamenti i Koordinimit Rajonal dhe Operative
<b>Divizioni</b>	Zyra Rajonale Prishtinë, Autoriteti i Likuidimit i PRN104 NSH Tregu
<b>Vendi i punës</b>	<b>NSH “Tregu”</b> -Tregjet e Prishtinës
<b>Nr. i Referencës</b>	22012024

### 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- Ofruesi i Shërbimeve angazhohet për ruajtjen dhe ngritjen e vlerës së pronës shoqërore.
- Ofruesi i shërbimeve është i obliguar të bëjë shpërndarjen e faturave me kohë në tregun përkatës, të sigurohet që fatura është pranuar me rregull dhe është nënshkruar nga qiramarrësi. Për qiramarrësit që nuk kanë pranuar faturën të mbahet evidenca dhe të lihet koment.
- Administrimin e faturave për secilin muaj (insertimin dhe ndarjen në follder).
- Informimin e qiramarrësve të parregullt në pagesa për grumbullimin e borxhit dhe obligimin për pagesë.
- Të evidentohen qiramarrësit që nuk kanë paguar dhe të përgatiten faturat për fillim të procedurës përmbartimore.
- Mbanë evidence për nr. e qiramarrësve aktive në sektorin ku punonjësi është caktuar ne pozitën e Inkasantit, si dhe evidenton asetet qe nuk janë duke u shfrytëzuar.
- Sipas nevojës/kërkesës përgatit raport lidhur me gjendjen ne sektorin përkatës ku punonjësi është caktuar ne pozitën e Inkasantit
- Ofruesi i shërbimeve i caktuar në këtë pozitë i kryen punët dhe detyrat shtesë sipas kërkesës së mbikëqyrësit të drejtpërdrejt.

### • 2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Aplikacioni i punësimit (konsiderohet si CV dhe vlerësohet nga Komisioni);
  - Kopjet e diplomave mbi kualifikimin arsimor;
-

- Dëshmi për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit/Pasaportës;
- Vërtetimin nga Policia e Kosovës se ka/nuk ka dosje penale në sistemin informativ të Policisë së Kosovës;
- Certifikatë nga Gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, si dhe
- çdo dokument që provon plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion.

### **3. Kërkesat e përgjithshme formale**

- Arsimitimi i kërkuar: Shkolla fillore apo e mesme.

### **4. Kërkesa specifike**

- Përvoja në punë/aktivitet të ngjashëm si dhe ish punëtorët e kësaj NSh-je me përvojë të ngjashme do të konsiderohet përparësi.

### **5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim**

- Aplikacioni i punësimit (konsiderohet si CV dhe vlerësohet nga Komisioni);
- Kopjet e diplomave mbi kualifikimin arsimor;
- Dëshmi për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit/Pasaportës;
- Vërtetimin nga Policia e Kosovës se ka/nuk ka dosje penale në sistemin informativ të Policisë së Kosovës;
- Certifikatë nga Gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit si dhe
- çdo dokument që provon plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion.

### **6. Mënyra e Aplikimit**

- Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kompletuar më së largu me datë 20.02.2024 në ora 16:00 në emalin [punesimi@pak-ks.org](mailto:punesimi@pak-ks.org).

### **7. Data e shpalljes së rezultateve të vlerësimit përfundimtar**

- Lista e kandidateve sipas vlerësimit përfundimtar, do të shpallet më së largu deri më datën 27.02.2024,, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,33>).

### **8. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët**

- Përmes kontakt telefonit, SMS dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,33>)
-